

VENDIM
Nr.63, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Beratit, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës Berat-Ura e Kuçit dhe Hingës (BRK-1, BRK-2, BRK-11), që kullon një sipërfaqe prej 4099 ha-sh, nga të cilat 150 ha me ngritje mekanike;

2.2 Zona e fushës së Kutallisë, Berat (BRK-4), që kullon me ngritje mekanike sipërfaqen prej 1300 ha-sh;

2.3 Zona e fushës së Starovës, Berat (BRK-8), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 250 ha-sh;

2.4 Zona e fushës së Uznovës dhe Peshtanit Berat, (BRK-9, BRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 150 ha-sh;

2.5 Zona e fushës së Kozarës, Kuçovë (KVK-1), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 1120 ha-sh;

2.6 Zona e fushës Goraj, Perondi, Tapi, Gegë, Kuçovë (KVK-2, KVK-4), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 1180 ha-sh;

2.7 Zona e fushës Tapi e Rreth Tapi (KVK-3), që kullon me rrjedhje të lirë sipërfaqen prej 350 ha-sh;

2.8 Pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.9 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

b) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) (një) përfaqësues i qarkut;

d) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;

dh) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano